



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRII

Numri i lëndës: 2024:217039

Datë: 12.02.2025

Numri i dokumentit: 06841653

P.nr.196/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRII - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit L.Sh. nga Vushtria, për shkak të veprës penale *Vjedhje Pylli* nga neni 349 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.2173/22, të datës 05.08.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor e publik me datë 06.02.2025 në praninë e prokurores së shtetit Vyrtyte Gërvalla, palës së dëmtuar Komuna Vushtri-Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve, përfaqësuesi me autorizim i palës së dëmtuar Safet Doroci, dhe të pandehurit L.Sh., me datë 06.02.2025 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa më datë 12.02.2025 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: L.Sh. nga i ati Sh..., e ëma N..., e vajzërisë M..., data e lindjes..., në Vushtri, ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, punon si moler herë pas here, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, edhe më parë i gjykuar.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 12.09.2022 rreth orës 22:00 minuta, në vendin e quajtur “Gorolak” fshati Skoçne, komuna Vushtri, i pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vetë apo dikë tjetër, pret dru pa leje, në pronësi komunale-publike, me qëllim vjedhje dhe atë drunjë të padamkosur dhe atë 336 copë trungje të llojit Bung, me diametër 8-10 cm, me lartësi 6 metra me vëllim prej 3.62 m³, me çka të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm pyjor në vlerë prej 436.36 euro,

- Me këtë ka kryer veprën penale *Vjedhje Pylli* nga neni 349 par.1 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, dhe nenit 349 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364, 449 të KPPK-së, e

GJ Y K O N

TË PANDEHURITË PANDEHURIT: L.Sh. i shqipton **DËNIM ME GJOBË** në shumën prej katërqind (**400**) euro i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprën penale tjetër në kohëzgjatje prej një (1) viti.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të dëmit të paguajë shumën prej 436.36 euro, palës së dëmtuar

Detyrohet i pandehuri në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) Euro dhe në emër të taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën njëzet (20) Euro.

Të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzë PP-II.nr.2173/22, të datës 05.08.2024, kundër të pandehurit L.Sh. në Vushtrri, për shkak të veprës penale *Vjedhje Pylli* nga neni 349 par.1 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata me datën 16.10.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë.

I pandehuri është udhëzuar për të drejtën e tij për të paraqitur kundërshtimet e provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës, i njëjti nuk ka paraqitur kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave brenda afatit ligjor të përcaktuar jo më vonë se 30 ditë.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 06.02.2025, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurorja e shtetit, i pandehuri si dhe pala e dëmtuar, përfaqësuesi me autorizim, në të cilën seancë i pandehuri ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë, ndërsa gjykata ka vazhduar me administrimin e provave.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor

Prokurorja e shtetit Vyrtyte Gërvalla në fjalën hyrëse ka deklaruar se në këtë shqyrtim gjyqësor pas administrimit të provave siç janë fletëparaqitjet për dëmtimin e pyllit e dt. 12.09.2022, raporti policor i dt. 01.06.2023 si dhe nga dëgjimi dëshmitarit Q.Q. vërtetohet se këtu i pandehuri L.Sh. e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze.

Ndërsa në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor me rastin e administrimit të provave siç është në radhë të parë fletëparaqitja për dëmtimin e pyllit

e përpiluar me datë 12.09.2022 vërtetohet se rojtari i pyllit ka hasur në të pandehurin si dhe personin tjetër i cili në këtë fazë të procedurës nuk ka ndonjë cilësi në këtë çështje penale, vërtetohet që të njëjtit kanë qenë duke prerë drunjtë në kohën dhe vendin e cekur si në këtë fletëparaqitje. Për të mbështetur të njëjtën është dëgjuar edhe rojtari- përpiluesi i kësaj paraqitje Q.Q., i cili pasi u njoftua me rastin në detaje pranë gjykatës deklaroi vendin saktësisht ku është hasur këtu i pandehuri, mënyrën se si kanë qenë drunjtë e prerë si dhe një fakt shumë të rëndësishëm e që i referohet faktit se sikur të pandehurit ashtu edhe personit F.Sh. ai i njëjti si në paraqitje ashtu ka edhe informacione të tjera lidhur me familjen ete njëjtëve. Sa i përket demit të shkaktuar në këtë çështje penale e kemi edhe shkresën që evidentohet si shënime personale dhe demit i shkaktuar, ku saktësohet nr. i trungjeve, diametri, vëllimi e po ashtu edhe vlera e demit e përcaktuar sipas akteve të brendshme të drejtorisë përkatëse.

Sa i përket mbrojtjes së të pandehurit, meqenëse i njëjti nuk u deklarua në këtë seancë por që është deklaruar në fazat e mëhershme, realisht nuk mund të bëhet një krahasim i deklaramit të tij me provat që i vihen në barrë për shkak se i njëjti vetëm ka deklaruar se nuk din asgjë për çështjen. Nga të gjitha këto prova, u vërtetua se i njëjti është fajtor për veprën që i vihet në barrë.

Tutja ka kërkuar nga gjykata që të njëjtin të e shpall fajtor, e me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merr parasysh si rrethanë rëndësuese demit që i është shkaktuar respektivisht që shkaktohen nga këto vepra penale në vazhdimësi si dhe faktin se i njëjti ka ra ndesh edhe me herët me ligjin, ndërkaq si rrethanë lehtësuese të i merret mosha e tij e re në kohën e kryerjes së veprës penale.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar në fjalën hyrëse ka deklaruar se e përkrah në tersi fjalën hyrëse të prokurorit të shtetit e gjithashtu si pale e dëmtuar ka parashtruar kërkesë pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale. Në fjalën përfundimtare po ashtu ka deklaruar se e përkrah fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit.

I pandehuri në fjalën hyrëse ka deklaruar se nuk e ndjen veten fajtor sepse gjatë asaj kohë i njëjti ka qenë në Suedi dhe nuk ka qenë në Kosovë fare dhe këtë e dëshmon përmes një video nga snapchat ku shihet që është në veturë së bashku me një koleg të tij me të cilin ka punuar në Suedi. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaramit të dhënë me herët dhe nuk e ndjen veten fajtor për veprën.

Provat që janë administruar në shqyrtim gjyqësor

Gjykata me rastin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit në pajtim me ligjin, më vëmendje të plotë dhe me përkushtim profesional, dhe me përkujdesje vërtetoi faktet kundër të pandehurit si dhe faktet në favor të tij duke i mundësuar të pandehurit, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të tij, ashtu që gjatë shqyrtimit gjyqësor bëri administrimin e këtyre provave:

Provat personale

- Marrja në pyetje e dëshmitarit Q.Q., në seancën e datës 06.02.2025, i cili ka deklaruar se vazhdimisht e ka takuar personin në fjalë duke prerë dru, po ashtu edhe më datë 12.09.2022 kishte hasur në të pandehurin, duke i'u referuar edhe fletëparaqitjes së plotësuar më këtë datë të cilës i qëndron pranë, nga e cila kishte konstatuar se të pandehurin e ka takuar në vendin e quajtur Gorolak duke prerë drunjë dhe duke i ngarkuar. I pandehuri ishte kishte qenë me F.Sh.n i mituri të cilët kishin qenë me traktor Ferguson, ramë dhe sharrë motorike, duke shtuar se të njëjtit i njeh pasi që janë të rregullte në prerjen e drunjëve. Dëshmitari shton tutje se atë natë mbrëmje ka dalë në pyll dhe po ashtu i akuzuari ka qenë duke prerë drunjë tek bërlloku afër rrugës, më pas e kam ndalur, traktorin ka qenë duke e vozitur djalit i B... (F...) ndërsa i akuzuari e kishte pranuar këtë vepër dhe kishte thënë se këto drunjë janë për të, dhe meqenëse kishin qenë të dytë i kishte paraqitur që të dy, lloji i drurit ka qenë Bungu dhe ka qenë i prerë me metër. Dëshmitari po ashtu ka deklaruar gjatë shqyrtimit gjyqësor se atë natë kishte shkuar me veturë private pasi që kishte marr informacion që në këtë pjesë është duke u prerë drunjë. Të njëjtëve u kishte kërkuar letërnjoftimet, të cilët nuk i kanë dhënë, mirëpo që kishin pranuar që është pyll shtetëror dhe të nesërmen pas që kishte bërë numërimin dhe matjen e trungjeve të prera ka përgatitur edhe raportin.

Provat materiale:

- Procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin L.Sh. i dhënë në polici, i datës 02.08.2024, ku i njëjti ka deklaruar se pasi që u njoftua në lidhje me se çfarë është në pyetje, për këtë çështje nuk di asgjë dhe nuk ka qenë prezent fare mirëpo gjithçka që i duhen ose i intereson prokurorisë ose gjykatës kur të ftohem nga ana e tyre do të dëshmojë para tyre dhe së nuk ka më çfarë të shtojë.

- Në fletëparaqitjen për dëmtimin e pyllit i datës 12.09.2022, nga dëshmitari Q.Q. ka përshkruar se në vendin e quajtur Gorolak në territorin e fshatit Skoçan, ka takuar duke prerë drunjë dhe duke i ngarkuar L.SH.in i cili ishte me F.Sh., të cilët ishin me traktor Ferguson, rom dhe sharrë motorike.

- Në shënimet nga dëmi i shkaktuar i datës 17.10.2022, më të cilën është përshkruar se me datë 12.09.2022, i pandehuri L.Sh. së bashku me F.Sh. në lokacionin Gorolak, në territorin e fshatit Skoçan është zënë duke prerë drunjë pa leje me qëllim vjedhje, dhe duke i transportuar dru të pa damakosura dhe pa dokumentacion përkatës, në sasi prej 3.62 m³, me diamtër 8-10 cm, me lartësi 6m, vëllimi 3.62 dhe me vlerën e dëmit të shkaktuar 436.36 euro.

- Në raportin policor t datës 01.06.2023, në të cilin është përshkruar fakti se me datë 01.06.2023 rreth orës 11:00, Stacioni Policor në Vushtrri-Njësia e Hetimeve kanë kontaktuar përmes telefonit me babain e L.Sh. – Sh.Sh., dhe i njëjti i ka njoftuar se djali i tij gjendet jashtë vendit më konkretisht në Suedi, ndaj të cilit ka edhe një Urdhër Arrest të lëshuar nga Gjykaya Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, dhe i njëjti posa të marr njoftimin do të intervistohet sipas autorizimit nga prokuroria.

Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet

Faktet jo kontestuese

Për gjykatën është fakt jo kontestues që në pronësi komunale – publike me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete apo dikë tjetër janë prerë gjithsej 362 trungje, dhe janë shkaktuar dëm material në vlerë prej 436.36 euro.

Fakte këto të vërtetuara nga dëgjimi i dëshmitarit, por edhe gjejnë mbështetje në provat në shkresat e lëndës.

Faktet kontestuese

Fakt kontestues për gjykatën dhe i domosdoshëm për tu provuar ishte fakti nëse i pandehuri ka qenë në kohën dhe vendin e përshkruar.

Si i ka vërtetuar gjykata faktet kontestuese

Meqenëse i pandehuri me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë, nuk e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës, gjykata për vërtetimin e faktit kontestues të lartcekur, si element qenësor për përmbushjen e figurës së veprës penale me të cilën ngarkohet i pandehuri, ka zhvilluar procedurën e provave, ku ka administruar këto prova:

Gjendja faktike e vërtetuar nga ana e gjykatës

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi, pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, analizimit të tyre një nga një dhe të gjitha së bashku, si dhe shikimit në shkresat e lëndës vërtetohet kjo gjendje faktike: se i akuzuari me datë, kohë dhe vend si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ka ndërmarrë veprimet inkriminuese për veprën penale me të cilën ngarkohet.

- Nga marrja në pyetje e dëshmitarit në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datën 06.02.2025 gjykata ka vërtetuar faktin se i njëjti pasi kishte marr informacione se në atë pjesë është duke u prerë dru, kishte shkuar në pyll atë mbrëmje dhe kishte takuar të pandehurin L.Sh. së bashku me djalin e B... (F.Sh.), i cili ishte duke prerë drunjë tek blloku afër rrugës dhe e kishte pranuar se këto drunjë ishin për të dhe se e pranon këtë veprë dhe po ashtu kanë pranuar se është pyll shtetëror, të njëjtëve u ka kërkuar letërnjoftimet mirëpo nuk i kanë dhënë, dhe se të nesërmen kishte shkuar për të bërë numërimin e drunjëve të prerë dhe majtën e tyre dhe të nesërmen kishte përgatitur raportin, megjithatë thekson se në një rast tjetër kur e kishte takuar vetëm në pyll të pandehurin i kishte kërkuar letërnjoftimin dhe i kishte dhënë, rast për të cilin ka paraqitur një fletëparaqitje tjetër. Tutje ka shtuar se i qëndron pranë fletëparaqitjes së bërë për këtë rast.

- Nga raporti për dëmin e shkaktuar i datës 17.10.2022 gjykata ka vërtetuar faktin se më datë 12.09.2022 L.Sh. së bashku me F.Sh., në vendin e quajtur Gorolak, në fshatin Skoçne, komuna Vushtrri, është zënë së bashku me të miturin duke prerë drunjë pa leje me qëllim vjedhje, duke transportuar dru të pa damakosur dh pa dokumentacion përkatës në sasi prej 3.62 m³, me gjithsej

362 drunjë të llojit Bungu, me lartësi 6m, më vëllim 3.62 m³, dhe me vlerë prej 436.36 euro, raport i përpiluar nga rojtari i pyllit Q.Q..

- Nga fletëparaqitja për dëmtimin e pyllit e datës 12.09.2022 gjykata ka vërtetuar faktin se më këtë datë rojtari i pyllit Q.Q. ka hasur në L.Sh. dhe F.Sh. në pyll duke prerë drunjë dhe duke ngarkuar, të cilët ishin më traktor Ferguson, rom dhe sharrë motorike.

Vlerësimi sipas ligjit i provave nga ana e gjykatës

Gjykata shqyrtoj me vëmendje të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe atyre që gjenden në shkresat e lëndës dhe provave të cilat shfaqin lidhshmërinë e plotë të të pandehurit me veprën penale të kryer u fali besim të plotë, pasi që të njëjtat janë marrë në procedurë të rregullt ligjore.

Gjykata i'a fali në tërësi besimin deklarimit të dëshmitarit në seancën e shqyrtimit kryesor, pasi që deklarimi i tij ishte konsistent, i plotë dhe në harmoni edhe me fletëparaqitjen të cilën e kishte bërë në natën që ishte zhvilluar ngjarja si dhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës, duke qenë se dëshmitari ka përshkruar në tërësi dhe në mënyrë të plotë rrjedhën e ngjarjes në natën kritike.

Gjykata vlerësoi edhe mbrojtjen e të pandehurit në fjalën hyrëse dhe përfundimtare, ndërsa deklarimit të tij nuk i'a fali besimin pasi që arsyetimi i tij se nuk di asgjë për rastin dhe se nuk ka qenë në Kosovë në atë kohë nuk është besueshme, sepse të gjitha dëshmitë në këtë rast, siç janë, dëshmia e dëshmitarit dhe provat materiale, vërtetojnë të kundërtën e asaj çka pretendon i pandehuri, pasi që i njëjti është mbrojtur në heshtje lidhur me këtë rast.

Neni 349 paragrafi 1 i KPRK-së përcakton formën themelore të veprës penale Vjedhje Pylli, ashtu që theksohet se: *“Kushdo që me qëllim të vjedhjes pret trungjet në pyll dhe sasia e druve të prerë tejkalon 2 metra kub, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.”*

Kjo gjykatë, konsideron se përtej çdo dyshimi të bazuar, është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, si në dispozitiv të aktgjykimit dhe se në veprimet e të pandehurit, manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale *Vjedhje Pylli* nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69, 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese ka vlerësuar moshën e tij të re në kohën e kryerjes së veprës penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar dëmin e shkaktuar ndaj mjedisit në të cilin jetojmë si dhe faktin se i njëjti ka rënë ndesh me ligjin edhe më parë dhe atë me aktgjykimin P.nr.258/2021 i plotfuqishëm me datë 02.08.2021, si dhe aktgjykimin P.nr.61/2020 i plotfuqishëm me datë 30.10.2023.

Duke vlerësuar të gjitha rrethanat e përshkruara më sipër gjykata të akuzuarin e gjykoji si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke gjetur se dënimi me gjobë në shumë prej katërqind (400) euro i është kushtëzuar në kohëzgjatje prej një (1) viti, për arsye se i njëjti punon herë pas here si moler, është dënim adekuat me shkallen e rrezikshmërisë se veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe pasojave të shkaktuara si dhe se me këtë dënim ndaj tij do të arrihet qëllimi i dënimit si në nenin 38 të KPRK-së. Duke i pasur parasysh të gjitha këto nuk ka pasur vend që të pandehurit t'i shqiptohet dënim me i butë ose me i rëndë.

Arsyet lidhur me vendimin për kompensimin e dëmit, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin mbi kompensimin e dëmit gjykata e mori në bazë të nenit 61 par.1 të KPRK-së, ku është përcaktuar se “Kur gjykata dënon personin i cili është shpallur fajtor për çfarëdo veprë penale që përfshin vjedhjen, humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë, gjykata do të urdhërojë kryesin që të bëjë dëmshpërblimin e viktimës së veprës penale”, e lidhur me nenin 462 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: “Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi”.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e morri në bazë të nenit 449 par.2 nën par.2.6 dhe nenit 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e morri në bazë të nenit 36 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga çka u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË-DEGA VUSHTRRI
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal,
P.nr.196/2024, datë 14.02.2025

Gjyqtari i vetëm gjykues
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën

Numri i lëndës: 2024:217039
Datë: 12.02.2025
Numri i dokumentit: 06841653